



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 shkurt 2018
Nr. ref.: RK 1199/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI123/17

Parashtrues

Hasim Eljami

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Rev. nr. 95/2017, të 15 majit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Hasim Eljami (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Miftar Islami, avokat nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 95/2017, i 15 majit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin ishte hedhur poshtë si e palejuar kërkesa e parashtruesit për revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 73/2016, i 29 dhjetorit 2016). Vendimin e kontestuar parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 13 qershor 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me paragrafin 1, të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], neni 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe paragrafin 2, të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 13 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës përmes postës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 tetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
7. Më 24 tetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës. Të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren, dega në Dragash, të dorëzojë fletëkthesën e cila tregon kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 95/2017, i 15 majit 2017.
8. Më 6 nëntor 2017, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Dragash, njoftoi Gjykatën se aktvendimi i lartcekur i Gjykatës i është dërguar përfaqësuesit ligjor të parashtruesit më 13 qershor 2017.
9. Më 11 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 24 nëntor 1988, Gjykata Komunale në Dragash (Aktgjykimi C. nr. 263/81) kishte vërtetuar bashkëpronësinë në emër të dy vëllezërve për një parcelë në fshatin Leshtan të komunës së Dragashit.
11. Në një datë të paspecifikuar, pasardhësit e njërit prej dy bashkëpronarëve parashtruan padë në Gjykatën Komunale në Dragash për vërtetimin e bashkëpronësisë në emër të tyre mbi pjesën prej 1/2 të parcelës.
12. Ndërkohë, pesë pasardhësit e bashkëpronarit tjetër, njëri prej të cilëve është edhe parashtruesi i kërkesës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës dhe të tjerët), parashtruan kundërpadi në gjykatën e lartcekur për vërtetimin e pronësisë të tërë parcelës kontestuese në bazë të parashkrimit fitues. Në kundërpadinë e tyre, ata pretenduan se parcelën e kontestuar në mënyrë të vazhdueshme që nga viti 1968 e kishin në posedim, mbajtje dhe shfrytëzim.
13. Më 29 maj 2013, Gjykata Themelore në Prizren, dega në Dragash (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) me Aktgjykimin (C. nr. 143/07) aprovoi kërkesëpadinë e paditësve, duke vërtetuar se ata ishin bashkëpronarë në pjesën prej 1/2 të parcelës së lartcekur, përkatësisht secili për pjesën ideale të 1/6 të parcelës. Gjykata Themelore, më tej obligoi parashtruesin e kërkesës dhe të tjerët që paditësve t'ua njohin këtë të drejtë pronësore, t'ua dorëzojnë në bashkëpronësi dhe në shfrytëzim të përnguar dhe t'ua lejojnë regjistrimin e pronës në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Urbanizëm. Në vijim, Gjykata Themelore refuzoi kundërpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe të tjerëve si të pabazuar, duke konstatuar se ata janë bashkëpronarë vetëm në pjesën prej 1/2 të parcelës.
14. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Themelore vërtetoi se nuk ishin përmbushur kriteret ligjore për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues. Në lidhje me pretendimet e paraqitura në kundërpadi, Gjykata arsyetoi se *“[...] në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm C. nr. 263/81 [të 24 nëntorit 1988] gjykata nuk i ka pranuar si të bazuara sepse kjo parcelë kontestuese është blerë me mjete financiare [...] nga babai i paditësve dhe babai i të paditurve e që të njëjtit e kanë shfrytëzuar këtë parcelë vite me radhë dhe atë deri në vitin 2001 ku me rastin e paraqitjes së propozimit për caktimin e mexhëve të parcelës ka lindur dhe kontesti mes palëve [në procedurë kontestimore]...”*.
15. Në një datë të paspecifikuar, kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtruesi i kërkesës dhe të tjerët parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tyre, parashtruesi dhe të tjerët pretenduan shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 29 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 3424/2013) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit dhe të tjerëve dhe aprovoi ankesën e paditësve si të bazuar.

17. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike. Gjykata e Apelit, duke iu referuar vërtetimit të gjendjes faktike dhe duke konstatuar se parcelën kontestuese e kishin shfrytëzuar edhe paditësit, vërtetoi se parashtruesi dhe të tjerët nuk e kanë fituar të drejtën e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore nuk ka bërë shkelje të dispozitave kontestimore dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale.
18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dhe të tjerët paraqitën revizion në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
19. Më 15 maj 2017, Gjykata Supreme (Aktvendimi Rev. nr. 95/2017) hodhi poshtë si të palejuar kërkesën për revizion.
20. Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), konstatoi se revizioni në këtë çështje juridike nuk është i lejuar, për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin edhe paditësit edhe parashtruesi i kërkesës dhe të tjerët e kishin cekur në paditë dhe kundërpaditë e tyre përkatëse pranë Gjykatës Themelore, është më e ulët se pragu i vlerës së objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e Ligjit të lartpërmendur.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme *“[...] në mënyrë drastike i [ka] cenuar [të] drejt[ën] kushtetuese e përshkruar në dispozitën e nenit 3 par. 1; 24 par.1; neni 46 par. 1, dhe nenit 102 par. 2, duke ju cenuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç janë Barazia para ligjit, E drejta e pronës së garantuar dhe E drejta në gjykim të pavarur dhe të drejtë, të cilat gjatë vendosjeve në rastin në fjalë si parime themelore nuk janë zbatuar”*.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike.
23. Ndërsa, sa i përket çështjes së vlerës së objektit të kontestit, parashtruesi pohon se: *“në qoftë se gjykata posaçërisht ajo e shkallës së parë konsideron se vlera e rastit nuk korrespondon me vlerën e vërtetë të tregut të kësaj paluajtshmërie ajo është dashur që në mbështetje të dispozitës së nenit 36 të LPK-së të kërkoj përcaktimin e vlerës reale të kontestit, siç nuk ka vepruar gjykata e shkallës së parë”*.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjkata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara më tej me Ligj dhe të specifikuara me Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

26. Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi ka përmbushur kriterin për dorëzimin e kërkesës së tij në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

27. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjkata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 95/2017, të 15 majit 2017, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka dorëzuar kërkesën e tij në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
28. Megjithatë, Gjkata më tej duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kriteret e parapara me nenin 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit dhe me rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët përcaktojnë:

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregulli 36
[Kriteret e Pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]

(d) parashtuesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

29. Gjykata rikujton se parashtuesi pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e parashtuesit të kërkesës, të garantuara me paragrafin 1, të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe paragrafin 2, të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
30. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës vetëm ka përmendur dispozitat dhe të drejtat e lartpërmendura të garantuara me Kushtetutë, por nuk ka arsyetuar fare apo paraqitur dëshmi se si këto të drejta të garantuara me Kushtetutë janë shkelur në rastin e tij.
31. Gjykata rikujton se parashtuesi në kërkesën e tij, në thelb pretendon vërtetim të gabuar të gjendjes faktike nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, në aktgjykimin e saj pas vërtetimit të gjendjes faktike dhe duke ju referuar dispozitave përkatëse ligjore ka konstatuar se paditësit janë bashkëpronarë në 1/2 të parcelës. Këtë konstatim të Gjykatës Themelore e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila në mënyrë të detajuar ka arsyetuar dhe po ashtu ka adresuar pretendimet e parashtuesit të paraqitura në ankesën e tyre.
32. Ndërsa, sa i përket vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykata vëren se Gjykata Supreme, duke iu referuar dispozitave përkatëse të së drejtës procedurale, kërkesën për revizion të parashtuesit e kishte hedhur poshtë si të palejuar për arsye se vlera e objektit të kontestit, të cilin paditësit e kishin cekur në padinë e tyre dhe e cila vlerë ishte konfirmuar edhe nga parashtuesi është më e vogël se pragu i vlerës së objektit të kontestit e përcaktuar në dispozitat e LPK-së.

33. Prandaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është kryesisht i pakënaqur me kualifikimin ligjor të fakteve dhe të ligjit të zbatuar nga gjykatat e rregullta.
34. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Gjykata vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
35. Gjykata po ashtu vë në dukje se fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta, si dhe vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës pa shtjelluar shkeljen e pretenduar të tyre, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
36. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur pretendimet e tij se si procedurat e përfunduara në gjykatat e rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e vendimeve të këtyre gjykatave. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, para. 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, para. 62.).
37. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të neneve 3, 24, 46 dhe 102 të garantuara me Kushtetutë, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur fare pretendimet e tij.
38. Prandaj, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d), kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e mbajtur më 11 janar 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

